



Dr. Ilir Muharremi

Biografia

Ilir Muharremi u lind më 1983 në Pejë. Shkollën fillore e kreu në Prishtinë, ndërsa shkollën e mesme të artit në Pejë. Ka diplomuar më 2004 në Fakultetin e Arteve, Dega e Aktrimit, në klasën e profesor Luan Dakës. Pas diplomimit është angazhuar në disa shfaqje teatrale, si: “Sfida e madhe” e autorit Nebi Islami, “Nata e dymbëdhjetë” e Ëilliam Shekspeare-t, “Duart e ndyta” e Zhan Pol Sartre-t, “Shkolla e grave” e Molierit etj. Në vitin 2007, me dramën “Van Goghu Kosovar”, ka kryer magjistraturën në Degën e Dramaturgjisë në Prishtinë. Ndërsa, në vitin 2010, ka doktoruar me temën: "Ekspresionizmi, absurdi, ekzistencializmi dhe cmenduria: katër dramat shqiptare\shfaqjet" në Fakultetin e Filologjisë “Kiril i Metodij” në Shkup. Aktivisht merret me aktrim, por shkruan edhe poezi, tekste dramatike, shkrime diskursive dhe kritike për artin e dramës, teatrin, filmin, artin figurativ, artin konceptual etj.

Ilir Muharremi në aktivitetin e vet shkencor interes të veçantë ka treguar edhe ndaj temave të arteve vizuale dhe të filozofisë, për çka shkruan vlerime dhe artikuj me karakter të ndryshëm. Aty flitet për çështje të ndryshme të pikturës, skulpturës dhe filozofisë. Edhe në këto trajtesa vërehet afiniteti i autorit ndaj paraqitjes informative të personalitetit të ndonjë piktori, si janë piktorët shqiptarë I. Kodra, A. Paci M. Mulliqi etj. Ose të huaj S. Dali P. Pikaso, A. Modelijani

përkatësisht për kryevepra të pikturës, si është “Mona Liza” e L. Da Vinçit. Kësaj pjese të veprimtarisë shkencore i përkasin edhe disa artikuj në të cilët trajtohen çështje të përgjithshme të skulpturës. Nga fusha e filozofisë veçohen publikimet për pikëpamjet e Fridrih Niçes dhe të Zhan Pol Sartrit. Është autor i tri librave: “Djalli në qytetin tim” (1996) , “Dera e fundit e çmendurisë” (2003), “Van Goghu kosovar” (2010). Më së fundmi punon si profesor në Fakultetin e edukimit në Prishtinë.

PR
DIOGEN pro kultura
<http://www.diogenpro.com>

NEKOPRATI